Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	6	
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Shërbimet)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					

Datë _____	
-------------------	--

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Paisjet dhe makineritë që do të transportohen objekt prokurimi, “Shërbim transporti dhe pozicionim në vend të nënstacioneve levizëse 35/10.5-63 kV, nga Qarri në Borsh dhe 110/35/10 kV nga Himara në Zëmlak Korçë”, si rikthim në destinacionin fillestar.

1. N/Stacioni lëvizës 35/10.5-63 kV, i përbërë nga dy pjesë, pjesa lëvizëse (nënstacioni lëvizës 35/10.5-63 kV) i vendosur në rimorkion e tij lëvizëse, si edhe konteneri i paisjeve, i cili do të transportohet nga Operatori Ekonomik fitues.

1.	Rimorkio me dy Akse
	Transf. Fuqise 7.5 MVA-35/10.5-6.3 kV 50Hz
	Transf. ndihm. 50 kV (Nev.Vetj.)10/6/0.4 kV
2.	Konteneri i strehimit (shelter Box) IP54

Me destinacion: Qarr Fier - Borsh

Borsh – Qarr Fier

2. N/Stacionin e Lëvizshëm 110/35/10 kV, i përbërë nga dy pjesë lëvizëse të vendosur mbi dy rimorkio/trajler.

1.	Trailer me tre akse për mbajtjen e transformatorit
	Transformator tensioni 110 kV
	Transformator tensioni 110 kV
	Transformator tensioni 110 kV
	Transformator fuqie 10 MVA
	Transformator i nevojave vetjake 30kVA; 10/0.4 kV
2.	Trailer me dy akse për mbajtjen e paisjeve të tjera TM

Me destinacion: Himare – Zëmbllak Korçë


Zëmbllak Korçë - Himarë

Specifikime teknike bashkëlidhur

Datat e kryerjes së shërbimit do të caktohen nga Autoriteti kontraktor.

Specifikime Teknike

1. Lëvizja e N/Stacionin e Lëvizshëm 110/35/10 kV (Himara në Korce, rikthim në Himare).



Nënstacioni Lëvizës Mobile Korçë

Nr.	Përshkrimi i asetit final	Njësia	Sasia	Barkodi
1	Software për sistemin SCADA dhe sistemet e komunik	1	PC	236489
2	Shkarkues elektrike 110 kV	1	PC	236476
3	Shkarkues elektrike 110 kV	1	PC	236475
4	Shkarkues elektrike 110 kV	1	PC	236474
5	Sistem i integruar 110kV te tipit COMPASS ose tip	1	PC	236473
6	Çelat e tensionit të mesëm 10.5 kV (transformator)	1	PC	236484
7	Çelat e tensionit të mesëm 10.5 kV (fideri)	1	PC	236483
8	Çelat e tensionit të mesëm 10.5 kV (fideri)	1	PC	236482
9	Çelat e tensionit të mesëm 37.5 kV (transformatori)	1	PC	236481
10	Çelat e tensionit të mesëm 37.5 kV (fideri)	1	PC	236488
11	Paneli AC	1	PC	236486
12	Sistemi i baterive dhe i karikimit	1	PC	236485
13	Paneli DC me 110 Vdc	1	PC	236492
14	Paneli I matjes, komandimit dhe mbrojtjes	1	PC	236491
15	Gjenerator Diesel portabël jo me pak se 40 kVA 50	1	PC	236498
16	Portal portativ që mundëson lidhjen 110 kV te N/S	1	PC	236497
17	Kabllo fleksibel 37.5kV dhe 10.5 kV per lidhjet m	1	PC	236496
18	Tokezimi I NST te levizshem dhe aksesoret	1	PC	SKA BC24
19	Portali i mbrojtjes nga shkarkimet	1	PC	236495
20	Mbrojtja ndaj zjarrit (vetem brenda shelerit)	1	PC	SKA BC26
21	Ndriçimi i jashtëm dhe i emergjencës (ndriçim I	1	PC	SKA BC27
22	Shelter-trailer për mbajtjen e transformatorit	1	PC	236494
23	Trailer për mbajtjen e paisjeve të tjera	1	PC	236493
24	Transformator tensioni 110 kV	1	PC	236480
25	Transformator tensioni 110 kV	1	PC	236479
26	Transformator tensioni 110 kV	1	PC	236478
27	Transformator fuqie 10 MVA	1	PC	236477
28	Transformator I nevojave vetjake 30kVA;10/0.4 kV	1	PC	236487
29	Kompjuter për sistemin SCADA dhe sistemet e komunikimit	1	PC	236490



www.deangelisimorchi.com
deangelis@deangelisimorchi.com
tel: 0544 509090 - fax: 0544 509157

DE ANGELIS

NOTE

- Controllare il serraggio dei dadi ruota dopo i primi 150 km, dopo 1000 km, in seguito periodicamente. Ripetere la stessa operazione alla sostituzione dei pneumatici. (coppia di serraggio 700Nm)

FERRAGGI

- Controllare periodicamente il serraggio di: cavallotti per assale (680Nm), bulloni per raila a sfere (250Nm), bulloni per perno di articolazione (M14 190Nm - M16 280Nm)

PNEUMATICI

- Controllare periodicamente la pressione di gonfiaggio che deve essere 9 +10 bar

LUBRIFICAZIONE

- Almeno una volta al mese oppure a seconda dell'uso (usare grasso tipo EP2)

MANUTENZIONE

- Per l'integrità dei componenti elettronici installati, È VIETATO effettuare saldature
- Eseguire periodicamente un controllo visivo di tutti gli organi in movimento per determinarne il perfetto funzionamento e l'eventuale stato di usura

AVVERTENZA ☞ L'intervento di personale non autorizzato, comporta il decadimento della garanzia

ZDA3S45F2GM006999

DE ANGELIS

Ciccio - Ravenna - Italia

VEHICLE (VEHICULE)	CATEGORY (CATEGORIE)
3S45F2 M0	O4
RS (mm)	C (mm)
11595	2400

SEMITRAILER
(SEMI-REMORQUE)

S (mm)	b (mm)
1750	11700

CHASSIS
(CHASSIS)


Smax (mm)	bmmax (mm)
Pmax (mm)	

DE ANGELIS

HOMELOCATION
(PROVINCIA)

VIN: ZDA3S45F2GM006999

Total (Totale)	IT		
0	48600 kg		
1	15000 kg		
2	11200 kg		
3	11200 kg		
4	11200 kg		
5	/ kg		
6	/ kg		
7	/ kg		
8	/ kg		
9	33000 kg		



Gjerësi maksimale më të madhe se 2.50 m; (në llogaritjen e kësaj gjerësie nuk futen pasqyrat te lëvizshme të shikimit prapa), por përfshihen izolatoret e TRANSFORMATORIT të fuqisë dhe paisjet e tjera Komoduese (mjet jashtë norme).


Lartësi maksimale më të madhe se 4 m; (mjet jashtë norme).

Gjatësi të përgjithshme, duke përfshirë dhe mekanizmat e tërheqjes, më të madhe se 7.50 m për mjetet me një aks, dhe 12 m për mjetet teke me dy e më shumë akse (mjetet që do të transportohen deri në 18-19 m, pra klasifikojnë në mjete jashtë norme).



2. N/Stacionin e Lëvizshëm 35/10.5-6.3 kV, Qarr Fier – Borsh dhe rikthim në destinacion.

Gjatësia rrugore për lëvizje: Qarr Fier – Borsh 202 km



Asetet e N/Stacionit lëvizës 35/10.5-6.3 kV (Qarr-Fier ne BORSH, rikthim ne Qarr Fier)

Nr.	Përshkrimi i asetit final	Njësia	Sasia	Barkodi
1	Rimorkio me 2 Akse	PC	1	225301
2	Transf. Fuqisë 7.5MVA-35/10.5-6.3Kv 50Hz	PC	1	225302
3	Transf. ndihm. 50Kva (Nev.Vetj.)10/6/0.4kV	PC	1	225303
4	Kontenieri i strehimit (shelter Box)IP54	PC	1	225291
5	Paneli TM 35/10.5/6.3kV mbrojtje	PC	1	225304
6	Paneli i Kontrollit	PC	1	225305
7	Sistem Baterive DC 110Vdc	PC	1	225306
8	Indikator 35-66 kv	PC	1	300686
9	Fikse Zjarri 6 KG ABC Pluhur	PC	1	300687
10	Shkalle për trajler	PC	1	300688
11	Fikse Zjarri 12 KG ABC Pluhur	PC	1	300689
12	Indikator 10-35 kv	PC	1	225298







DE ANGELIS

HOMOLOGATION (HOMOLOGATION)

VIN

ZDA2S35F3GM007014

IT


Total (Total)	35000	kg		kg
0	15000	kg		kg
1	10000	kg		kg
2	10000	kg		kg
3	/	kg		kg
4	/	kg		kg
5	/	kg		kg
6	/	kg		kg
7	/	kg		kg
8	/	kg		kg
T	20000	kg		kg

Kontenieri i strehimit (shelter Box) IP54



Informacion i rëndësishëm

Operatori ekonomik përpara fillimit të procesit të lëvizjes së N/Stacionit të Lëvizshëm 110/35/10kV (Korçë) dhe N/Stacionin e Lëvizshëm 35/10.5-6.3kV (Qarr-Fier), për në destinacionet përkatëse duhet të kontrollojë gjëndjen teknike të rimorkiove ku janë vendosur të gjitha pjesët përbërëse sipas targetës së mëposhtme.



- **Rrotat**

Kontrollo shtrëngimin e rrotave pas çdo 150 km dhe pas 1000 km. Çifti rrotave rrotulluese me forcë 700 Nm.

- **Shtrëngimet**

Kontrollo në mënyre periodike shtrëngimin:

Kavallotat per Aks, 680 Nm

Buloneritë 250 Nm

Buloneritë dhe pernot lidhese: M14 190 Nm – M16 280Nm

- **Gomat**

Kontrollo në mënyrë periodike presionin e gomave që duhet të jenë 9-10 bar.

- **Lubrifikimi**

Lyeni një herë në muaj pjesët lidhëse-lëvizëse, ku lidhet koka e trailerit me rimorkion (ganxha) me graso EP2.

- **Saldimet**

Ndalohet reptësisht saldimet

Makineritë/mjetet e nevojshme për kryerjen e shërbimit të transportit.

Informacion mbi mjetet jashte norme.

Gjerësi maksimale më të madhe se 2.50 m; (në llogaritjen e kësaj gjerësie nuk futen pasqyrat te lëvizshme të shikimit prapa), por përfshihen izolatorët dhe paisjet e tjera Komoduese (mjet jashte norme).

Lartësi maksimale më të madhe se 4 m; (mjet jashte norme).

Gjatësi të përgjithshme, duke përfshirë dhe mekanizmat e tërheqjes, më të madhe se 7.50 m për mjetet me një aks, dhe 12 m për mjetet teke me dy e më shumë akse (mjetet që do të transportohen deri në 18-19 m, pra klasifikohen në mjete jashte norme).

- a) Autovinç me kapacitet 100 ton. Sasia një mjet



Do të shërbejë:

1. Ngritje dhe pozicionimin e kontenerit i strehimit (shelter Box) IP54, në trajlerin lëvizës, si edhe në vendin e caktuar në Borsh dhe Qarr Fier .

Pesha e kontenierit 2,200 kg, Gjatësi 6 m, Gjërësi 2.45 m, Lartësi 2.45 m

2. Lëvizje dhe pozicionim i Rimorkiove të N/Stacionit të Lëvizshëm 110/35/10 kV.

Pesha maksimale e manovrimit 48000 kg (ref tragetes se rimorkios)


Aksi i lëvizjes / largësia nga pozicionimi i vinçit tek aksi i rimorkios: max 10 m

Llogaritje orientuese për zgjedhjen e vinçit

Çdo vinç ka një tabelë / grafik të ngarkesës që specifikon aftësitë e vinçit. Detajon veçoritë e tij dhe mënyrën se si kapaciteti i tij ndryshon kur merret parasysh distanca dhe këndi i ngritjes së ngarkesës.

Për të ilustruar kemi zgjedhur të njëjtin Tip Vinçi me kapacitetet ngritëse: 100 Ton

Në këto kushte zgjedhim një vinç me kapacitet ngritës 100 TON, për të llogaritur në kushte ideale peshën që mund të ngrihet në varësi të distancës dhe pozicionimit të vinçit me Rimorkiot e Nëstacioneve Lëvizëse.



Marrim në studim një vinç Kapcitet ngritës 100 t . $\ddot{E}_c = 100 \text{ t}$.

Forca në pikën FA duhet të jetë e barabartë me zero $F_A = 0$ (që vinçi të mos rezohet)

Duhet të llogarisim peshën maksimale që mund të ngrejë vinçi me një krahë 10 m.

Atëherë duhet të gjejmë FB, e barabarte me peshën maksimale që mund të ngrje vinçi ($\ddot{E}$), ne menyre qe forca në pikën FB të jetë zero.

$\ddot{E}_c = 100 \text{ ton}$. $\ddot{E}$ = **peshen maksimale që mund të mbajë vinçi llogaritet :**

$$\sum W_B = 0 = 4.5 \text{ m} * 100 \text{ t} - 10 \text{ m} \times W$$

$$9 \text{ m} \times W = 4.5 \text{ m} \times 100 \text{ t}$$

$$W_{\max} = 4.5 \times 100 / 9$$

$$W_{\max} = 50 \text{ t}$$

b) Kokë tërheqëse traileri. Sasia 3 (tri) mjete levizëse

Mjet special transporti për realizimin e transportit të kontenierit në destinacion përkatës që do të realizohet në kontratë. (Tërheqës me 2-3 akse)


Foto orientuese



c) RIMORKIO / TRAILER. Sasia 1 (nje) mjet levizes

Mjet special transporti për realizimin e transportit të gjithë pjesëmarrësve (vajtje-ardhje) për destinacion përkatës që do të realizohet në kontratë.
(Trailer Rimorkio me kapacitet mbajtes mbi 5 ton)





Rimorkio për transport Kontenieresh

Gjatësi 8.203 mm

Gjerësi 2.480 mm

Bazamenti i rrotave 5.70 mm

Pesha e kontenierit që do të transportohet: 2200 kg

Gjatësi 6 m

Gjerësi 2.45 m

Lartësi 2.45 m

d) Eskordë Shoqërimi. Sasia 2(dy) mjete lëvizëse

Eskorta përbehet nga mjete shoqëruese (makina të vogla me sinjalizim viziv) të cilat ndihmojnë gjatë transportit të kontenierëve ose N/Stacioneve levizese nga njëri destinacion në tjetrin. Sinjalizojnë organet kompetente dhe qytetarët se po kryet një transport jashtë norme dhe i rëndësishë së veçantë.

Eskorta përbëhet në përgjithësi ka 2 makina, njëra makinë siguron lëvizjen përpara, lajmeron dhe garanton drejtuesin e mjetit kamionit që transporton N/Stacionin lëvizës. E dyta lëviz/qëndron prapa N/Stacionit për të parandaluar që mos të bëhen parakalime të gabuara.



Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen: **“Shërbim transporti dhe pozicionim në vend të nënstacioneve levizëse 35/10.5-63 kV, nga Qarri në Borsh dhe 110/35/10 kV nga Himara në Zëmlak Korçë, si edhe rikthimin e tyre në destinacion fillestar pas përfundimit të qëllimit të kërkesës”**.

PROGRAM PARAPRAK SHERBIMI				
Objekti	“Shërbim transporti dhe pozicionim në vend të nënstacioneve levizëse 35/10.5-63 kV, nga Qarri në Borsh dhe 110/35/10 kV nga Himara në Zëmlak Korçë”, si edhe rikthimin e tyre në destinacionin fillestar, pas përfundimit të qëllimit të kërkesës.			
Vendi / date Fillim shërbimi	Përshkrimi i punimeve	Sasia	Vendi / date Mbarim shërbimi	Afati i kryerjes së transportit
Qarr Fier	Levizje nënstacionit levizës 35/10.5-63 kV, nga Qarri në Borsh	1	Borsh Himare	24 ore
Borsh Himare	Levizje nënstacionit levizës 35/10.5-63 kV, nga Borsh Himare në Qarr Fier	1	Qarr Fier	24 ore
Himare Zëmlak Korçë	Levizje nënstacionit levizës “110/35/10 kV nga Himara në Zëmlak Korçë	1	Zëmlak Korçë	24 ore
	Levizje nënstacionit levizës “110/35/10 kV nga Himara në Zëmlak Korçë	1	Himare	24 ore

Afatet e ekzekutimit: 12 (dymbëdhjetë) muaj

Shtojca 7

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, me mjete jashtë norme dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënua me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- c. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

Argumentimi: *Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, mepërrjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe

financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare 2019, 2020, 2021 një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 40, neni 43 dhe neni 55 pika 4, të V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, V.K.M Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. “ Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar ...”. Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

2.2.2 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti kontraktor do të kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve të deklaruara si më lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe ligjin Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar Autoritetin Kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kështëve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 4, neni 55, pika 4/b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

1. Operatori ekonomik duhet të posedojë 1(një) autovinç me kapacitet ≥ 100 ton.

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

- a) Disponimi i autovinçit duhet vërtetuar me regjistrimin e mjetit *duhet të paraqitet:*

Per mjetin ne pronesi

1. *Leje qarkullimi (e vlefshme)*
2. *certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
3. *Police sigurimi (e vlefshme)*

Per mjetin me qera,

-
1. Për mjetin e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
 2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
 3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
 4. Police sigurimi (e vlefshme)

b) Për mjetin që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre duke paraqitur aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetin dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentim: Për të pozicionuar në ç'do vend/mjetet lëvizëse (N/Stacionet levizese), kontenierin e strehimit të nënstacioneve lëvizës 35/10.5-63 kV, si dhe për ç'do emergjence tjetër gjatë transportit, duke patur parasysh vështirësitë e rrugës në segmentin e BORSHIT, si dhe trafikun e ngarkur në perudhën e sezomit turistik.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar një manovrator të pajisur me dëshmi drejtimi të lëshuar nga institucionet përkatëse për manovrimin e autovinçit. Për këtë qëllim operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e punës me manovratorin, si edhe dëshmi të drejtimit.

Argumentim: Për të drejtuar dhe manovruar vinçin e kërkuar.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

3. Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion të paktën 3 mjete speciale transporti (KOKA TRAJLERI) për realizimin e transportit për destinacion përkatës që do të realizohet në kontratë (tërheqës me me tre akse 1 cope dhe terheqës me dy akse 2 cope).

Disponimi i mjeteve speciale transporti duhet vërtetuar me regjistrimin e mjetit (dokumentin leje qarkullimi) në emër të operatorit ekonomik, certifikatën e kontrollit teknik, si dhe siguracionin e mjetit (të vlefshëm). Nëse mjete të tilla janë marrë me qira, dokumentat që vërtetojnë regjistrimin e tyre (dokumentin leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshëm), shoqëruar me kontratën përkatëse të qirasë.

Argumentim: Për të kryer tërheqjen e 3 (tre) rimorkiove të nënstacioneve lëvizëse, kryerjen e transportit në destinacion të N/Stacionit lëvizës 35/10.5-63 kV, nga Qarri në Borsh (dy trailer) dhe N/Stacionit lëvizës 110/35/10 kV nga Himara në Zëmlak Korçë” (dy trajler), si edhe rikthimin në destinacionin fillestar.

4. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Eskortë dhe me Përgjegjës Teknik të Çertifikuar

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Për këtë qëllim operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e punës me Përgjegjës të Teknik të Çertifikuar.

Argumentim: Duke qënë se kemi të bëjmë me mjete jashtë norme (vinxha, mallra me dimensione të mëdha, peshë, gjatësi gjërësi, lartësi), është e nevojshme për arsye sigurie gjatë lëvizjes të jenë të shoqëruar me eskortë teknike. Eskorta bën të mundur që gjatë transportit të vinxhave ose pjesëve të tjera jashtë norme të kryen sipas rregullave dhe të mos krijojë probleme në qarkullimin në segmentet rrugore në të cilat do të kryet shërbimi.

Çertifikata me të cilën duhet të jetë e pajisur operatori është:

ÇKP (Çertifikata e kompetencës profesionale), lëshuar nga Drejtoria e përgjithshme e transportit rrugor.

5. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar te pakten 5 drejtues mjetei (shofer).

a) Tre (3) drejtues të mjeteve speciale përkatëse Tërheqes/Trajler.

Me leje drejtimi “KATEGORIA CE” e vlefshme.

b) Dy (2) drejtues të eskortës teknike shoqeruese.

Me leje drejtimi “KATEGORIA BE” e vlefshme.

(Këtu futet edhe Përgjegjësi Teknik i Çertifikuar).

Për këtë qëllim operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e punës me drejtuesat e mjeteve, dëshmin e drejtimit përkatës.

Argumentim: Për drejtimin e 5 mjeteve lëvizëse.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij

-Ky kriter do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, dhe këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

- (Sipas përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar

Tre kokat e trajlrave
vlefshme

Me leje drejtimi “KATEGORIA CE” e

Dy makinat e Eskordës Shoqëruese.
vlefshme

Me leje drejtimi “KATEGORIA BE” e

6. Police sigurimi në rast aksidenti.

Argumentim shpjegues: Duke qënë se kemi të bëjme me mjete jashtë norme (dimensione jashtë norme dhe pesha të rënda) të cilat do të transportohen në rruget e Republikës së Shqipërisë të cilat Administrohen nga ARRSH, është e nevojshme të kemi si garanci një Polcisë Sigurimi në rast aksidenti apo dëmtimi të cilat mund të ndodhin në rrugë, në të cilat do të operojnë operatorët. Gjithasthu bazuar dhe në kërkesat e vetë ARRSH për transporte jashtë norme është e domosdoshme kjo “Policë e sigurimit”.

8. Operatori ekonomik duhet të jetë i paisur me: Çertifikatën e Sistemit të Menaxhimit Mjedisor ISO 14001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente të tij.

Argumentim: Qëllimi i kërkesës së Çertifikimit me Çertifikatën e Sistemit të Menaxhimit Mjedisor ISO 14001, është të përcaktojë aktivitetet që duhen bërë për të minimizuar dëmet në tokë, ajër dhe ujë dhe në mjedis, duke zvogëluar përdorimin e burimeve natyrore gjatë aktivitetëve të organizatave. Mjedisi, i cili përfshin ajrin, tokën, ujin, florën (komunitetin e bimëve), faunën (komunitetin e kafshëve), me burimet natyrore, qeniet njerëzore të përdorura nga një organizatë në kryerjen e aktivitetëve të saj, përcaktohet si mjedis. Fatkeqësisht, mjedisi në të cilin njerëzit jetojnë së bashku, dëmtohet gjithnjë e më shumë nga industria dhe zhvillimet teknologjike. Shkatërrimi i mjedisit natyror dhe ndotja e krijuar gjithnjë e më shumë kërcënojnë jetën njerëzore dhe cilësinë e jetës. Kjo është arsyeja pse ka filluar të bëhen rregulla ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare për mjedisin dhe po zhvillohen kërkesat e standardeve mjedisore për të parandaluar dëmtimin e vazhdueshëm në mjedis.

9. Operatori ekonomik duhet të jetë i paisur me: Çertifikatën e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente të tij.

Argumentim: ISO 9001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë për një organizatë/opertor ekonomik me qëllim:

a) të demonstrojë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte dhe shërbime që

plotësojnë kërkesat e klientit dhe të aplikueshme statutore dhe rregullatore.

b) synon të rrisë pritshmërinë e klientit nëpërmjet aplikimit efektiv të sistemit, duke

përfshirë proceset për përmirësimin e sistemit dhe sigurimin e konformitetit me kërkesat e klientit, ligjet dhe rregullat në fuqi.

Kërkesat e ISO 9001:2015 janë të përgjithshme me synimin e zbatimit për çdo organizatë, pavarësisht nga lloji ose madhësia e saj, ose produktet dhe shërbimet që ofron.

Qëllimi i kërkesës së Çertifikimit me Çertifikatën ISO 9001:2015, specifikon sigurinë në shërbimet e organizatës përkatëse që ofron shërbimin. Është kërkesë si rezultat i një

qasjeje menaxhimi në përputhje me sistemet e pranuar ndërkombëtarisht dhe kusht për vazhdimësinë e cilësisë së shërbimit të organizatës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

